



Technical Assistance for Strengthening the Capacity of the Ministry of Environment, Forests and Water Administration in Albania for Law Drafting and Enforcement of National Environmental Legislation

A project for Albania funded by the European Union

**Draft
VKM¹
Për Mbrojtjen e Shëndetit nga Rreziku i Ekspozimit ndaj Asbestit në Punë**

**Draft 1
Version 2**

29 Gusht 2013

***DRAFT 1
VERSION 2***

¹ VKM transponon Direktivën 2009/148/EC, të datës 30 Nëntor 2009, për mbrojtjen e punëmarrësve nga rreziku i ekspozimit ndaj asbestit gjatë punës, botuar në Fletoren Zyrtare OJ L330/28, 16.12.2009.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRATEV
VENDIM

(Dated _____)

Nr. _____, datë _____

PER MBROJTJEN E SHENDETIT NGA RREZIKU I EKSPOZIMIT NDAJ ASBESTIT
NE PUNE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 38 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe neneve 37, 38, 40 të Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” me propozim të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrit të Mjedisit;

VENDOSI:

I. Qëllimi

1. Vendimi ka për qëllim të garantojë mbrojtjen e shëndetit në punë të punëmarrësve nga rreziku i ekspozimit ndaj asbestit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve që shfaqen ose mund të shfaqen nga ky ekspozim duke përcaktuar vlerat e lejuara dhe kërkesa të tjera të veçanta.

II. Perkufizime

2. Në këtë vendim termat e mëposhtme kanë këtë kuptim:

a) ‘asbest’ përfshin silikatet fijore të mëposhtme:

- (i) aktinolit, CAS Nr. 77536-66-4,
- (ii) gruenerite/amosit, CAS Nr. 12172-73-5,
- (iii) antofilit, CAS Nr. 77536-67-5,
- (iv) krisotil, CAS Nr. 12001-29-5,
- (v) krokidolit, CAS Nr. 12001-28-4,
- (vi) tremolit, CAS Nr. 77536-68-6.

b) “Autoritetet përgjegjëse” janë Ministria përgjegjëse për mjedisin, Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, Inspektoriati Shtetëror i Punës, Agjensite Rajonale të Mjedisit.

c) “Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë” është Ligji Nr. 10237, date 18.2.2010 për “Sigurinë dhe shëndetin në punë”;

ç) “Ligji për mbetjet” është Ligji Nr. 10463, date 22.9.2012 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”;

- d) “Ministria” është ministria përgjegjëse për shëndetin dhe sigurinë në punë;
- dh) “Ministri” është ministri që drejton ministrinë përgjegjëse për për shëndetin dhe sigurinë në punë.
- e) “Ministri përgjegjës për mjedisin” është ministri që mbulon politikat për çështjet e mjedisit në fushën e veprimtarisë përkatëse.
- ë) “Ministri përgjegjës për shëndetësinë” është ministri përgjegjës për politikat e shëndetit publik, përfshirë dhe ato të shëndetit në punë.
- f) “Ndërmarrje” ka kuptimin që jepet në Ligjin Nr. 10237, date 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.
- g) “Pajisje mbrojtëse individuale (PMI)” është çdo pajisje e përdorur nga punëmarrësi për të mbrojtur veten kundrejt një ose më shumë rreziqesh.
- gj) “Personi përgjegjës për kontrollin mjekësor” është personi i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë siç parashikohet në nenin 5 paragrafi 15 i Ligjit Nr. 10237, date 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, mjeku i familjes, institucionet shëndetësore publike apo jo-publike që zbulojnë sëmundjen gjatë kontrollit klinik.
- h) “Përfaqësues i punëmarrësve” ka kuptimin që jepet në Ligjin Nr. 10237, date 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”;
- j) “Punëmarrës” ka kuptimin që jepet në Ligjin Nr. 10237, date 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”;
- k) “Punëdhënës” ka kuptimin që jepet në Ligjin Nr. 10237, date 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.
- l) “Veprimtari/punë me afat të shkurtër” në lidhje me asbestin përfshin çdo veprimtari që brenda periudhës shtatë ditore:
 - i. nuk zgjat më shumë se dy orë;
 - ii. përfshirja e punëmarrësit në të nuk zgjat më shumë se një orë.
- ll) “Vlera kufi” ka kuptimin që jepet në paragrafin 49 të këtij vendimi.

III. Fusha e veprimit

- 3. Dispozitat e këtij vendimi do të zbatohen në të gjitha sektorët e veprimtarisë ku punëmarrësit janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj pluhurit që perftohet nga asbesi ose nga materialet që përmbajnë asbest.
- 4. Veprimtari të tilla përfshijnë industrinë e nxjerrjes së asbestit, punimet e ndërtimit, të shembjes, të mirëmbajtjes, të riparimit, heqjen apo kapsulimin e asbestit apo materialeve që përmbajnë asbest në godina, anije dhe ne në veshjet e tyre dhe veprimtaritë për agjësimin e mbetjeve.

IV. Ndalimet

- 5. Veprimtaritë e mëposhtme, që vijnë si rezultat i trajtimit dhe asgjësimit të produkteve gjatë shembjes dhe heqjes së asbestit janë të ndaluara:
 - a) Përdorimi i asbestit me anë të procesit të spërkatjes;
 - b) Proceset që përfshijnë përdorimin e izolimit me densitet të ulët (më pak se 1 g/cm³) ose të materialeve izolues ndaj zhurmave të cilat përmbajnë asbest;
 - c) Nxjerrja e asbestit;

- ç) Prodhimi dhe përpunimi i produkteve që përmbajnë asbest;
- d) Prodhimi dhe përpunimi të produkteve që përmbajnë sasi asbesti të shtuar në mënyre të qëllimshme.

V. Identifikimi i pranisë së asbestit

- 6. Punëdhënësi nuk duhet të ndërmarrë kryerjen e punimeve të shembjes, riparimit ose punimeve të tjera, të cilat ekspozojnë apo ka gjasa të ekspozojnë punëmarrësit ndaj asbestit derisa ai të ketë verifikuar dhe provuar mungesën e pranisë së asbestit.
- 7. Përpara fillimit të punimeve të shembjes ose të mirembajtjes, punëdhënësi do të marrë masat e nevojshme për të identifikuar materialet e dyshuara për përmbajtje asbesti, duke mbledhur informacion nga pronari/ët e ndërtesës.
- 8. Masat e parashikuara në këtë Vendim do të zbatohen kur ka dyshime për përmbajtje të asbestit në materiale dhe ndërtime të tjera ekzistuese.

VI. Vlerësimi i rrezikut të ekspozimit ndaj asbestit

- 9. Në veprimtaritë që mund të shfaqin rrezik të ekspozimit ndaj pluhurit të ose të materialeve që përmbajnë asbesti, punëdhënësi duhet të kryejë Vlerësim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm të Rrezikut për të:
 - a. Përcaktuar natyrën dhe shkallën e ekspozimit të punëmarrësve ndaj pluhurit të asbestit apo materialeve që përmbajnë asbest; dhe
 - b. Identifikuar masat që duhet të merren për të përmbushur kërkesat e këtij Vendimi.
- 10. Punëdhënësi duhet të sigurojë zbatimin e masave të parashikuara në gjermën b të paragrafit 9.
- 11. Vlerësimi i rrezikut duhet të përfshijë:
 - a) Tipin e asbestit ndaj të cilit punëmarrësit mund të ekspozohen;
 - b) Natyrën dhe shkallën e ekspozimit ndaj asbestit që mund të shfaqet gjatë punës.
 - c) Rezultatet e monitorimit të ekspozimit ndaj asbestit në përputhje me paragrafin 51;
 - ç) Masat parandaluese ndaj ekspozimit ose uljen e nivelit të pranisë së asbestit më poshtë se niveli i arsyeshëm praktik;
 - d) Rezultatet e kontrollit mjekësor përkatës; dhe
 - dh) Çdo informacion tjetër të vlefshëm që punëdhënësit i nevojitet për të plotësuar Vlerësimin e Rrezikut.
- 12. Punëdhënësi do të përgatisë gjetjet dhe konkluzionet e Vlerësimit të Rrezikut menjëherë pas përfundimit të tij.
- 13. Punëdhënësi do të njoftojë dhe konsultojë me punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre brenda ndërmarrjes gjetjet dhe përfundimet e Vlerësimit të Rrezikut.

14. Punëdhënësi do të mbajë kopje të Vlerësimit të Rrezikut në godinën e ndërrmarrjes përkatëse për aq kohe sa vazhdon procesi i punës në fjalë.
15. Punëdhënësi rishikon Vlerësimin e Rrezikut:
- a) Cdo gjashtë muaj rregullisht;
 - b) Menjëherë, në qoftë se:
 - (i) Ka arsye të mjaftueshme për të dyshuar se Vlerësimi i Rrezikut nuk është më i vlefshëm;
 - (ii) Ka ndryshim thelbësor në kushtet e punës për të cilën është kryer Vlerësimi i Rrezikut; ose
 - (iii) Rezultatet e monitorimit të ajrit të kryera në përputhje me paragrafin 51 tregojnë që është i nevojshëm.
16. Punëdhënësi ndryshon Vlerësimin e Rrezikut kur:
- a) Ka arsye për të besuar se nuk është i saktë;
 - b) Ka ndryshim në kushtet e punës;
 - c) Nga rishikimi del nevoja për ndryshim të Vlerësimit të Rrezikut
17. Punëdhënësi kryen dhe regjistron ndryshimet sipas germs “c” të paragrafit 16, ne rastet kur ato janë rezultat i drejtpërdrejt i gjetjeve dhe përfundimeve të Vlerësimit të Rrezikut.
18. Punëdhënësi mund të shmangë zbatimin e kërkesave të parashikuara në paragrafët 32-39; 65-71; dhe 72-76, në rastet kur ekspozimi i punëmarrësve ndaj asbestit është:
- a) I çrregullt dhe me intensitet të ulët;
 - b) Kur nga përfundimet e Vlerësimit të Rrezikut të parashikuar në paragrafin 9 rezulton se vlera kufi e ekspozimit ndaj asbestit në ajër nuk do të tejkalohet në vendin ku punohet.
19. Rastet e shmangieve të parashikuara në paragrafin 18 përfshijnë:
- a) Veprimtari të shkurtra, jo të vazhdueshme mirëmbajtjeje, në të cilat përdoren materiale jo fijore;
 - b) Heqje pa shkatërrim e materialeve jo të degraduara në të cilat fijet e asbestit janë pazgjidhshmërisht të lidhura;
 - c) Kapsulim ose mbyllje të materialeve që përmbajnë asbest dhe që janë në gjendje të mirë.
 - ç) Kontroll dhe monitorim të ajrit dhe mbledhja e mostrave për të vlerësuar nëse materiali në fjalë përmban asbest.
20. Ministri, nëpërmjet urdhrave miraton udhëzimet praktike për përcaktimin e shkallës së ekspozimit të çrregullt dhe me intensitet të ulët ndaj asbestit, siç parashikohet në paragrafët 18 dhe 19.
21. Udhëzimet e parashikuara në paragrafin 20 do të hartohen në përputhje me legjislacionin dhe praktikën përkatëse në fuqi, pas konsultimeve me përfaqësues të punëdhënësve dhe punëmarrësve.

VII. Licensimi për kryerjen e punimeve me prani të asbestit

22. Punëdhënësi duhet të pajiset më licence për punimet me prani të asbestit para fillimit të punës në rastet kur:
- a) Ekspozimi i punëmarrësve ndaj asbestit nuk është i çrregullt dhe me intensitet të ulët;
 - b) Vlerësimi i Rrezikut nuk mund to tregojë qartësisht se vlera kufi nuk do të tejkalohet;
 - c) Në punimet e veshjes me shtresë asbesti;
 - d) Në punimet e izolimit me pllaka asbesti ose asbest për të cilat vlerësimi i rrezikut:
 - (i) tregon që gjatë punës ekspozimi i punëmarrësve ndaj asbestit nuk është i çrregullt dhe me intensitet të ulët,
 - (ii) nuk tregon qartësisht se vlera kufi nuk do të tejkalohet
 - (iii) tregon që puna nuk është afatshkurtër;
23. Ministri nëpërmjet urdhërave miraton kërkesat të cilat duhet të përmbushen nga punëdhënësit për tu lejuar të punojnë me asbest.
24. QKL lëshon licencat për punimet me asbest bazuar në legjislacionin e veçantë për licencat, autorizimet dhe lejet.

VIII. Plani i punës

25. Punëdhënësi para fillimit të punimeve me prani të asbestit do të hartojë një Plan Pune të detajuar për punën që do të kyejë.
26. Plan i Punës i parashikuar në paragrafin 25 përfshin punimet e shembjes, punimet për largimin e asbestit dhe /ose materialeve që përmbajnë asbest nga ndërtesat, strukturat, godinat industriale dhe anijet.
27. Plani i Punës do të përshkruajë masat e nevojshme që do të ndërmerren për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në vendin e punës në përputhje me ligjin për mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë në punë.
28. Plan i Punës duhet veçanerisht të specifikojë:
- a) heqjen e asbestit apo materialeve që përmbajnë asbest përpara fillimit të punimeve të shembjes, me përjashtim të rastit kur kjo paraqet rrezik më të madh për punëmarrësit krahasuar me rastin kur asbesti dhe / ose produkte që përmbajnë atë të kishin mbetur në vend në punimet në fjalë;
 - b) pajisjen kur është e nevojshme me pajisjet mbrojtëse individuale;
 - c) verifikimin për mungesë të rrezikut të ekspozimit të punëmarrësve ndaj asbestit pas përfundimit të punimeve të shembjes dhe heqjes së asbestit në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin dhe sigurinë në punë.
29. Plan i Punës duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:
- a) natyrën dhe kohëzgjatjen e mundshme të punës;

- b) vendin ku të kryhet puna;
- c) metodat që do të përdoren kur puna përfshin trajtimin e asbestit ose të materialeve që përmbajnë asbest;
- ç) karakteristikat e pajisjeve që do të përdoren për:
 - (i) mbrojtjen dhe dekontaminimin e punëmarrësve të përfshirë,
 - (ii) mbrojtjen e personave të tjerë të pranishëm ose në afërsi të vendit të punës.
- d) masat që do të ndërmerren punëdhënësi për të siguruar përmbushjen e detyrimeve dhe kërkesave për parandalimin dhe zvogëlimin e ekspozimit ndaj asbestit;
- dh) masat që do të ndërmerren punëdhënësi për të siguruar përmbushjen e detyrimeve për pastrimin e godines apo ndërmarrjes siç parashikohet në paragrafin 47.

- 30. Punëdhënësi do të mbajë kopje të Planit të Punës në godinën e ndërmarrjes përkatëse për aq kohe sa vazhdon procesi i punës në fjalë.
- 31. Me kërkesë të autoriteteve përgjegjëse, plani i punës i parashikuar në paragrafin 25 duhet ti dergohet autoritetit që e kërkon para fillimit të punës së planifikuar.

IX. Sistemi i njoftimit

- 32. Punëdhënësi në kushtet e parashikuara në paragrafët 18-19, do të ndërmerren masat e parashikuara në paragrafët 33-39.
- 33. Veprimtaritë e parashikuara në paragrafin 3 do të mbulohen nga një sistem njoftimi.
- 34. Punëdhënësi parafillimit të punimeve me prani të asbestit do ti përcjellë Inspektoriatit të Punës njoftimin e parashikuar në paragrafin 33, në përputhje me legjislacionin përkatës, rregulloret dhe procedurat administrative në fuqi.
- 35. Punëdhënësi duhet të njoftojë Inspektoriatin e Punës jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë para fillimit të punimeve të licencuara me prani të asbestit.
Ky njoftim do të përfshijë:
 - a) Emrin e subjektit njoftues, adresën dhe numrin e telefonit të selisë ku subjekti njoftues ushtron veprimtarinë;
 - b) Përshkrim të shkurtër të:
 - (i) vendndodhjes së zonës së punës;
 - (ii) llojit dhe sasisë së asbestit të përdorur ose të trajtuar;
 - (iii) veprimtarisë dhe proceseve që përfshihen;
 - (iv) numrin e punëmarrësve të përfshirë;
 - (v) masave të marra për të kufizuar ekspozimin e punëmarrësve ndaj asbestit
 - c) datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e punës;
 - d) çdo ndryshim tjetër i cili ndryshon të dhënat e njoftimit, duke përfshirë përmbylljen e punimeve, me shkrim dhe menjëherë.
- 36. Për punimet me prani të asbestit të cilat nuk kanë nevojë licencimi dhe nuk janë të përjashtuara nga zbatimi i këtij vendimi, punëdhënësi duhet të njoftojë Inspektoriatin e Punës, dhe të dorëzojë pranë tij:

- a) Të dhënat e parashikuara në paragrafin 35 germa a deri c, përpara fillimit të punimeve;
- b) Menjëherë çdo ndryshim që passjell ndryshim të të dhënave të parashikuara në paragrafin 35, gërma a deri c.

37. Inspektoriati i Punës administron sistemin e njoftimit për punimet me prani të asbestit.

38. Punëmarrësit dhe /ose përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje do të kenë qasje në dokumentet të cilat janë subjekt i njoftimit sipas paragrafit 33 në përputhje me ligjet në fuqi.

39. Punëdhënësi detyrohet të dorëzojë njoftim të ri në rastet kur konstatohet rritje e konsiderueshme e ekspozimit ndaj pluhurit të asbestit apo të materialeve që përmbajnë asbest.

X. Parandalimi dhe zvoglimi i ekspozimit ndaj asbestit

40. Punëdhënësi për veprimtaritë e parashikuara ne paragrafin 3 duhet të sigurojë që ekspozimi ndaj pluhurit të asbestit ose materialeve që përmbajnë asbest në vendin e punës:

- a) të parandalohet sa më shumë të jetë praktikisht e mundur;
- b) në rast të pamundësisë së parandalimit të zvoglohet në minimum dhe në çdo rast poshtë vlerës kufi.

41. Punëdhënësi për të përmbushur kërkesat e paragrafit 40, do të marrë veçanerisht masat e mëposhtme:

a) Në çdo kohë:

- (i) Të kufizojë në numrin më të ulët të mundshëm numrin e punëmarrësve të ekspozuar ose në rrezik ekspozimi ndaj pluhurit të përftuar nga asbesti ose nga produktet që përmbajnë asbest në vendin e punës;
- (ii) Të miratojë tipin e përshtatshëm të pajisjes mbrojtëse të frymëmarrjes në përputhje me standardet përkatëse, dhe të pajisë punëmarrësit dhe detyrojë ata ti përdorin kur ekspozohen ose janë në rrezik ekspozimi ndaj pluhurit të përftuar nga asbesti ose nga produktet që përmbajnë asbest në vendin e punës. Këto pajisje do të zvogëlojnë përqendrimin e asbestit në ajrin e thithur nga punëmarrësit në vlerën e cila është:
 - Poshtë vlerës kufi;
 - Sa më poshtë që të jetë praktikisht e mundur

b) Ne rastet kur parandalimi e ekspozimit ndaj asbestit është praktikisht i pamundur punëdhënësi do të:

- (i) Projektojnë ato proçese pune qe nuk prodhojnë pluhur asbesti dhe kur kjo nuk është e mundur;
- (ii) Shmangë çlirimin e pluhurit të asbestit në ajër;
- (iii) Kontrollojë ekspozimin në burim, nëpërmjet sistemeve të përshtatshme të ajrimit dhe masave organizative të nevojshme.

- c) Do të sigurojë pastrimin dhe mirëmbajtjen në mënyrë efektive dhe rregullisht e të gjitha ndërtesave dhe makinerive të përfshira në trajtimin e asbestit;
 - ç) Do të sigurojë mbledhjen dhe heqjen me shpejtësi të mbetjeve të asbestit dhe materialeve që prodhojnë pluhur asbesti në paketim të përshtatshëm, të mbyllur dhe të pajisur me etiketë për përmbajtjen e asbestit. Këto masa nuk do të zbatohen në veprimtaritë minerare. Në këtë rast mbetjet do të trajtohen në përputhje me ligjin për mbetjet.
 - d) Do të sigurojë që asnjë punëmarrës të mos jetë i ekspozuar ndaj asbestit me përqendrim në ajër më të madh se vlera kufi.
- dh) Në rastet kur vlera kufi është tejkaluar punëdhënësi duhet:
- (i) Të njoftojë menjëherë punëmarrësit e përfshirë dhe përfaqësuesit e tyre;
 - (ii) Të sigurojë ndërprerjen e punës në zonën e prekur derisa të jenë marrë masat e përshtatshme për zvogëlimin e ekspozimit nën vlerën kufi;
 - (iii) Të identifikojnë me shpejtësi arsyet e tejkalimit të vlerës kufi;
 - (iv) Të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e gjendjes dhe të parandalojë përsëritjen e saj në të ardhmen;
 - (v) Të kontrollojë menjëherë efektivitetin e masave të marra nëpërmjet matjeve të pranise së asbestit në ajër.

42. Punëdhënësi do të ndërmarrë masa të nevojshme që synojnë të sigurojnë mbrojtjen e punëmarrësve në vendin e punës në rastet e punimeve civile të shembjes, heqjes, rregullimit dhe mirembajtjes gjatë të cilave parashikohet të tejkalohet vlera limit e përcaktuar në paragrafin 23, pavarësisht masave mbrojtëse teknike të marra për uljen e përqendrimit të asbestit në ajër.

43. Punëdhënësi do të konsultojë masat e parashikuara në paragrafin 42 me punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje para fillimit të punimeve në fjalë.

44. Punëdhënësi do të ndërmarrë në veçanti këto masa:

- a) pajisjen e punëmarrësve më pajisje të frymëmarrjes dhe pajisje të tjera mbrojtëse të cilat duhet të vishen gjatë punës;
- b) vendosjen e shenjave paralajmëruese për të treguar se parashikohet që vlera kufi do të tejkalohet;
- c) parandalimin e perhapjes së pluhurit të përfutur nga asbesti ose nga materiale që përmbajnë asbest jashtë ndërtesës ose vendit të punës.

XI. Pajisjet mbrojtëse individuale të frymëmarrjes

45. Punëmarrësit, në të gjitha rastet kur ekspozimi ndaj asbestit nuk mund të ulet nën vlerën kufi pavarësisht mjeteve të përdorura, do të veshin pajisje mbrojtëse individuale për frymëmarrjen. Kjo mund të mos jetë e vazhdueshme dhe duhet të mbahet aq sa është domosdoshmërisht e nevojshme për çdo punëmarrës.

46. Punëdhënësi gjatë periudhave të punës të cilat kërkojnë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale, do të parashikojë ndërprerje të punës në varësi të kushteve fizike dhe klimatologjike. Këto ndërprerje do të vendosen në konsultim me të punësuarin dhe / ose përfaqësuesit e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi

XII. Masat që merren në vendin e punës me ekspozim ndaj asbestit

47. Punëdhënësi, në veprimtaritë e parashikuara në paragrafin 3 dhe në paragrafët 18 dhe 19 do të ndërmarrë masa për të siguruar që:
- a) vendi ku kryhen veprimtari të tilla:
 - (i) të jetë i rrethuar dhe i dallueshëm nga tabela paralajmëruese;
 - (ii) të lejohet hyrja vetëm për personat të cilët për shkak të punës së tyre apo detyrave janë të detyruar të hyjnë në të;
 - (iii) të përcaktohen vendet ku pirja e duhanit është e ndaluar.
 - b) Të jenë të përcaktuara vendet ku punëmarrësit mund të hanë dhe të pinë pa u rrezikuar nga ndotja me pluhur asbesti;
 - c) Veshjet e punës të qëndrojnë brenda ndërmarrjes. Në rast se pastrimi i tyre brenda ndërmarrjes është i pamundur, ato mund të dërgohen për tu pastruar në vende të specializuara për këtë jashtë saj. Në këtë rast veshjet do të transportohen në konteniere të mbyllur;
 - ç) Të jenë të përcaktuara vendet e ruajtjes për veshjet e punës, pajisjet mbrojtëse dhe veshjet personale të punëmarresve
 - d) Të ketë hapësira të përshtatshme të larjes dhe të tualetit, duke përfshirë dushet në rastet e veprimtarive me ekspozim ndaj pluhurit të asbestit;
 - dh) Të ketë vend të posacëm për pajisjet mbrojtëse, duke i kontrolluar dhe pastuar pas çdo përdorimi dhe duke marrë masa për të riparuar ose zëvendësuar pajisjet e dëmtuara para përdorimit pasardhës.
48. Kostos e shpenzimeve për masat e parashikuara në paragrafin 47 nuk ju ngarkohen punëmarrësve dhe përballohen nga punëdhënësi.

XIII. Vlerat kufi dhe matja e përqendrimit të fijeve të asbestit

49. Vlera kufi e lejuar e asbestit është 0.1 fibra për cm³ në një periudhë kohe prej 8 orësh (TWA).
50. Punëdhënësi do të sigurohet që asnjë punëmarrës të mos jetë i ekspozuar ndaj përqendrimit të asbestit më të madh se vlera kufi e parashikuar në paragrafin 49.
51. Punëdhënësi në varësi të rezultateve të vleresimit fillestar të rrezikut për të siguruar ruajtjen e vlerës kufi të parashikuar në paragrafin 49, duhet të kryejë rregullisht matjen e fijeveve të asbestit në ajer në zonën ku punohet.
52. Mostrat e marra për matjet e parashikuara në paragrafin 51 duhet të perfaqësojnë punëmarrësit e ekspozuar ndaj pluhurit të perftuar nga asbesti ose materialet që përmbajnë asbest.

53. Marrja e mostrave do të kryhet pas konsultimit me punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje.
54. Marrja e mostrave do të kryhet nga personel i kualifikuar. Mostrat e marra do të analizohen, në përputhje me paragrafin 56, në laboratore të pajisur me aparatura për numërimin e fijeve.
55. Kohëzgjatja e marrjes së mostrave do të jetë e tillë që ekspozimi i përfaqësuesit të përzgjedhur të shtrihet në një periudhë tetë orëshe (një ndërresë), me anë të matjeve ose nëpërmjet llogaritjeve të ponderuara të kohës.
56. Numërimi i fijeve do të kryhet nëpërmjet mikroskopit me kontrast (PCM) në përputhje me metodën e rekomanduar nga OBSH-ja (Organizata Botërore e Shëndetësisë), e vitit 1997 ose çdo metodë tjetër që ndiqet për të njëjtin qëllim dhe jep të njëjtin rezultat.
57. Për të matur asbestin në ajër, siç parashikohet në paragrafin 51, do të numërohen vetëm fijet me gjatësi më të madhe se 5 micrometra, gjërësi më të vogël se 3 micrometra dhe me një raport gjatësi/gjërësi më të madh se 3:1.

XIV. Programi i formimit

58. Punëdhënësit do të sigurojnë formimin e duhur për të gjithë punëmarrësit të cilët janë ose ka të ngjarë të jenë të ekspozuar ndaj pluhurit që përmban asbest.
59. Formimi duhet të kryhet sistematikisht dhe pa kosto për punëmarrësit.
60. Përmbajtja e formimit duhet të jenë lehtësisht e kuptueshme për punëmarrësit. Ajo duhet të mundësojë atyre fitimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme në drejtim të parandalimit të ekspozimit ndaj asbestit dhe sigurisë në punë:
61. Programi i formimit duhet të përfshijë:
 - a) veçoritë e asbestit dhe ndikimin e tij mbi shëndetin, duke përfshirë edhe ndikimin negativ të shumëfishaur në rastin e pirjes së duhanit;
 - b) llojet e materialeve që mund të përmbajnë asbest;
 - c) veprimtaritë që mund të rezultojnë në ekspozim ndaj asbestit dhe rëndësinë e kontroleve parandaluese për të zvogluar ekspozimin;
 - ç) praktikatat e sigurta të punës, kontrollet dhe masat mbrojtëse;
 - d) përdorimin e përshtatshëm, zgjedhjen dhe funksionin e duhur të pajisjeve të frymëmarrjes;
 - dh) procedurat për rastet urgjente;
 - e) procedurat për dekontaminim;
 - ë) trajtimin e mbeturinave;
 - f) kërkesat e kontrollit mjekësor.

62. Programi për fomimin e punëmarrëve për trajtimin e asbestit do hartohet nga Ministria dhe do të miratohet nga Ministri.

XV. Transparenca dhe e drejta e informimit

63. Punëdhënësi duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar që punemarresit dhe/ose përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje për veprimtarite e parashikuara ne paragrafin 3 të marrin informacion e duhur në lidhje me:

- a) rreziqet e mëdha për shëndetin nga ekspozimi ndaj pluhurit që përftohet nga asbesti apo nga materialet që përmbajnë asbest;
- b) vlerën kufi të përqendrimit të asbestit dhe nevojën për monitorim të atmosferës;
- c) kërkesat për ruajtjen e higjenës, përfshirë nevojën për ndalimin e duhanpirjes;
- ç) masat që merren në lidhje me veshjen në punë dhe përdorimin e pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse;
- d) masat e tjera të veçanta që ndihmojnë në zvogëlimin e ekspozimit ndaj asbestit.

64. Punëdhënësi përveç masave që parashikohen në paragrafin 63 dhe në kushtet e paragrafëve 18 dhe 19, do të ndërmarrë masa shtesë të përshtatshme për të siguruar që punëmarrësit dhe / ose përfaqësuesit e tyre në ndërmarrje:

- (i) të kenë qasje në rezultatet e matjeve të përqendrimit të asbestit në ajër;
- (ii) të marrin shpjegime në lidhje me domethënien e rezultateve të matjeve të përqendrimit të asbestit në ajër;
- (iii) të informohen sa më shpejt kur rezultatet tregojnë tejkalim të vlerës kufi të lejuar dhe arsyet që sollën atë;
- (iv) të informohen mbi masat që do të ndërmerren, ose, në rast urgjence, të informohen për masat që janë ndërmarrë

XVI. Kontrolli i mjekësor dhe kujdesi ndaj shëndetit

65. Punëdhënësi, përveç rasteve të parashikuara në paragrafët 18 dhe 19, do të ndërmarrë masat e parashikuara ne paragrafët 66 deri 71, për të siguruar që:

- a) vlerësim i gjendjes shëndetësore të çdo punëmarrësi të kryhet para fillimit të ekspozimit ndaj pluhurit që përftohet nga asbesti ose materialet që përmbajnë asbest në vendin e punës;
- b) vlerësimi i gjendjes shëndetësore të kryhet çdo tre vjet, për aq kohë sa vazhdon ekspozimi.
- c) kartelë individuale mjekësore të krijohet për çdo punëmarrës të ekspozuar sipas parashikimit në germen “a” të këtij paragrafi.

66. Vlerësimi i parashikuar në paragrafin 65 duhet të përfshijë kontroll të posaçëm të gjoksit.

67. Shtojca I përfshin rekomandimet praktike për kontrollin klinik të punëmarrësve. Rekomandimet ndryshojnë sipas zhvillimeve teknike.

68. Pas kontrollit mjekësor të parashikur në nënparagrafin e dytë të paragrafit 67 mjeku ose personi përgjegjës për mbikëqyrjen mjekësore të punëmarrësve duhet që në përputhje me legjislacionin në fuqi:
- të këshillojë ose të përcaktojë të gjitha masat individuale parandaluese dhe mbrojtëse që duhet të ndërmerren;
 - të informojë dhe këshillojë punëmarrësit në lidhje me kontrollin mjekësor të shëndetit të tyre të cilit mund të duhet ti nënshtrohen pas përfundimit të ekspozimit.
 - Të informojë punëmarrësit që mbikëqyrja mjekësore duhet të vazhdojë edhe pas përfundimit të ekspozimit për aq kohë sa është e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të tyre.
69. Masat e parashikuara në germen (a) të paragrafit 68 përfshijnë, kur është e përshtatshme, edhe tërheqjen e punëmarrësit në fjalë nga të gjitha ekspozimet ndaj asbestit.
70. Mbikëqyrja e vazhdueshme do të kryhet në përputhje me legjislacionin për shëndetin dhe sigurinë në punë.
71. Punëmarrësit ose punëdhënësi mund të kërkojnë rishikim të vlerësimit të parashikuar në paragrafin 68 në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin dhe sigurinë në punë.

XVII. Regjistrat

72. Punëdhënësi në rastet e parashikuara në paragrafin 18 dhe 19, do të ndërmarrë masat e parashikuara në paragrafët 73 deri 79.
73. Punëdhënësi duhet të krijojë dhe mbajë **Regjistrin e Ekspozimit** ndaj asbestit, në të cilin do të shënohen:
- punëmarrësit e ngarkuar për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në paragrafin 3;
 - natyra e veprimtarisë;
 - kohëzgjatja e ekspozimit;
 - ekspozimin ndaj të cilit janë rrezikuar apo prekur
74. Punëdhënësi do të sigurojë që:
- Mjeku dhe / ose autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen mjekësore të ketë qasje në regjistër;
 - Punëmarrësit të kenë qasje në regjistër për rezultatet e tyre individuale
 - Punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesit e tyre të kenë qasje në informacionin anonim dhe përmbledhës të regjistrit.
75. Regjistri i parashikuar në paragrafin 73 dhe të dhënat mjekësore të parashikuara në paragrafin 65 gërma a do të mbahen për të paktën 40 vjet pas përfundimit të ekspozimit, në përputhje me ligjin për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe ligjeve të tjera të veçanta.

76. Dokumentacioni i parashikuar në paragrafin 75, do t'i dorëzohet autoritetit kompetent në rastet kur ndërmarrja pushon veprimtarinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
77. Punëdhënësi duhet të krijojë dhe të mbajë **Regjistrin e Rasteve të Shfaqjes së Sëmundjes** pë të regjistruar të gjitha rastet e sëmundjeve të mushkërive, aparatit të frymemarrjes (asbestosis) dhe sëmundjeve kancerogjene (mesotheolima) për punëmarrësit e ekspozuar ndaj pluhurit të përfutur nga asbesti dhe ndaj materialeve që përmbajnë asbest
78. Punëdhënësi do të raportojë Ministrisë dhe Ministrin përgjegjës për shëndetësinë në fund të çdo viti kalendarik të dhënat e **Regjistrin të Rasteve të Shfaqjes së Sëmundjes**, edhe në rastet kur nuk ka të tilla.
79. Ministri përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe Ministri përgjegjës për shëndetësinë, bazuar në të dhënat e marra sipas paragrafit 78, do të krijojnë dhe mbajnë regjistrat e tyre për të gjitha rastet e sëmundjeve të mushkërive, aparatit të frymemarrjes (asbestosis) dhe sëmundjeve kancerogjene (mesotheolima) për punëmarrësit e ekspozuar ndaj pluhurit të përfutur nga asbesti dhe ndaj materialeve që përmbajnë asbest në nivel kombëtar për çdo tip aktiviteti të parashikuar në paragrafin 3.
80. Punëdhënësi do të krijojë dhe mbajë **Regjistrin e Asgjësimit të Asbestit** dhe të dhënat e tij do tja përcjelle Agjensise Rajonale përkatëse në juridiksionin e së cilës ushtron veprimtarinë në fund të çdo viti kalendarik.

XVIII. Sanksionet

81. Për shkelje të dispozitave të këtij vendimi do të zbatohen sanksionet e parashikuara në nenin 43 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për shëndetin dhe sigurinë në punë", në Kapitullin VI të Ligjit Nr. 9634, datë 30.10.2006, "Për Inspektimin në punë dhe Inspektoriatin Shtetëror të Punës", në Seksionin IV të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe në Kreun XIV të Ligjit Nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve".

XIX. Raportimi për zbatimin e vendimit

82. Ministria harton Raportin e Zbatimit në lidhje me zbatimin praktik të këtij vendimi në formën e një kapitulli të veçantë brenda raportit për shëndetin dhe sigurinë në punë.
83. Ministri nëpërmjet urdhrave miraton formatin që do të përdoret për përgatitjen e kapitullit të veçantë për asbestin së bashku me informacionin që duhet të përfshihet në të.
84. Inspektoriati Shtetëror i Punës, Inspektoriati Shtetëror për Mjedisin, Instituti i Sigurimeve Shëndetësore dhe institucione të tjera relevante do të sigurojnë dhe të përcjellin Ministrisë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e raportit të zbatimit parashikuar në paragrafin 82.

85. Raporti i Zbatimit i parashikuar në paragrafin 82 publikohet ne faqen zyrtare të internetit të Ministrisë dhe është i hapur për publikun.

XX. Dispozita të fundit

86. The Ministria përgjegjëse për shëndetin dhe sigurinë në punë, Ministria përgjegjëse për mjedisin, Inspektoriati Shtetëror i Punës, Agjensia Kombëtare e Mjedisit janë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

87. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

KRYEMINISTER

Shtojca I

Rekomandime praktike për vlerësimin klinik të shëndetit të punëmarrësve të parashikuar ne Kreun XVI paragrafi 67

1. Njohuritë e deritanishme tregojnë se ekspozimi ndaj fijeve të lira të asbestit është shkak për sëmundjet e mëposhtme:

- sëmundje të rënda të mushkërive (asbestosis);
- kancer të mushkërive;
- tumore bronkiale;
- kancer të aparatit tretës gastro-intestinal carcinoma.

2. Mjeku dhe / ose autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen mjekësore të punëmarrësve të ekspozuar ndaj asbestit duhet të jenë të njohur me kushtet dhe rrethanat e ekspozimit të secilit punëmarrës.

3. Kontrolli i shëndetit i punëmarrësve do të kryhet në përputhje me parimet dhe praktikat e mjekësisë profesionale. Ai do të përfshijë:

- historinë klinike dhe profesionale të punëmarrësit;
- intervistë personale,
- Kontroll klinik të përgjithshëm, veçanërisht të rrugëve të frymëmarrjes;
- Testet e funksionit të mushkërive (vëllime ne frymemarrje dhe numrin e frymemarrjeve/min).

Mjeku dhe / ose autoriteti përgjegjës për mbikëqyrje shëndetësore do të vendosë për kontrollet e mëtejshme, të tilla si testi citologjik i pështymës apo ekzaminimi me rreze x i krahërorit ose tomodensimetri, bazuar në njohuritë dhe arritjet më të fundit të lidhura me shëndetin në punë.